



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.shk.II.nr.54/2022

GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e Shkallës së Dytë, në përbërje nga gjyqtari individual Faton Bajrami, në çështjen përmbarimore të kreditorit R... (...), me seli në Prishtinë, kundër debitorëve DPT “T... M...” me përfaqësues M.S, Komuna e Gjilanit (garantues personal) dhe B.S, Komuna e Gjilanit (garantues), me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, P.nr.20/20 CPK.nr.23/20, të datës 17.06.2020, me datë 01.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit R... (...), me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, P.nr.20/20 CPK.nr.23/20, të datës 17.06.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktvendimin e atakuar P.nr.20/20 CPK.nr.23/20, të datës 17.06.2020, e ka aprovuar pjesërisht kërkesën e përfaqësuese të debitorëve M.S dhe B.S që të dy Komuna e Gjilanit, për shpenzimet e procedurës dhe ka detyruar kreditorin R... me seli në Prishtinë, që në emër të shpenzimeve procedurale, për përpilimin e prapësimit nga ana e avokatit të debitorëve, t'i paguaj shumën prej 320 €, ndërsa ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesës për shpenzime në lartësi prej 304€ e kërkuar jashtë nr. tarifor 6 dhe 9të OAK, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktvendimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovojë si të bazuar ankesën e kreditorit, ashtu që të ndryshojë aktvendimin e atakuar apo t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala debitorë.

Gjykata Komerciale, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën

Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori R... (....), me seli në Prishtinë, me datë 16.01.2020, ka paraqitur propozim për përmbartim, kundër debitorëve DPT "T... M..." me seli në Gjilan (kredimarrësi), M.S nga Gjilani (garantues personal) dhe B.S nga Gjilani (garantues), në bazë të dokumentit përmbartimor-ekzekutiv – Marrëveshjen mbi kredinë nr.200716779 e datës 03.12.2018, dhe Marrëveshjen mbi lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa Biznes kredit kartelës e datës 01.02.2019, për pagesën e borxhit në shumë të përgjithshme prej 15,401.11 euro.

Përmbartuesi privat Kushtrim M. Musa, duke vepruar në bazë të propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.20/20 të datës 17.01.2020, ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori me datë 28.01.2020, ka ushtruar prapësim duke theksuar se urdhrin përmbartimor është nxjerr nën shkelje të dispozitave të procedurës përmbartimore, respektivisht nenit 36 të LPP-së, e që në rastin konkret marrëveshja mbi kredinë nuk është e noterizuar, andaj i propozon gjykatës së shkallës së parë të aprovoi prapësimin dhe të anuloi urdhrin përmbartimor.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori, duke theksuar se prapësimi i debitorit është plotësisht i pathemeltë dhe i pabazuar pasi që debitori nuk është e thirrur në asnjë nga shkaqet e prapësimit të parapara në nenin 71 të LPP-së, andaj edhe ka kërkuar që të refuzoi prapësimin, dhe urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar P.nr.20/20 Cpk.23/20, të datës 18.04.2020, i korrigjuar me datë 26.06.2020, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr.20/20 të dt.17.01.2020, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivit të të njëjtit. Me datë 21.05.2020 debitorët paraqesin propozim për plotësimin e aktvendimit lidhur me shpenzimet e procedurës, me propozim gjykatës që të marr aktvendim lidhur me shpenzimet e procedurës, ashtu që kreditori të detyrohet të paguajë shumën në lartësi prej 624 euro për përpilimin e prapësimit nga ana e avokatit të debitorëve në pajtim me nr. tarifor 6 dhe 9 të OAK. Gjykata duke vendosur lidhur me kërkesën e debitorëve morri aktvendim plotësues P.nr.20/20 CPK.nr.23/20 të datës 17.06.2020, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesën e debitorëve për shpenzimet e procedurës dhe ka detyruar kreditorin t'ia paguaj shumën prej 320 € në emër të shpenzimeve procedurale.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikimin në shkresat e lëndës dhe kërkesës së debitorëve gjeti se kërkesa e përfaqësueses të debitorëve është pjesërisht e bazuar, andaj e detyroi kreditorin që në emër të shpenzimeve procedurale, për përpilimin e prapësimit nga ana e avokatit të debitorëve, t'i paguajë shumën prej 320€, kurse pjesën tjetër e

refuzoi për shumën prej 304€ ngase është e kërkuar jashtë nr. tarifor 6 dhe 9 të OAK. Vendimin që kreditori t'i bart shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në nenin 449 dhe 452 të LPK-së në lidhje me nenin 17 të LPP-së.

Gjykata Komeriale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komeriale-Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komeriale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka konstatuar gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale, kur e ka aprovuar pjesërisht kërkesën e palës debitorë duke u bazuar në nenin 449 të LPK-së i cili përcakton *“Shpenzimet procedurale përbëhen nga harxhimet e bëra gjatë dhe lidhur me procesin gjyqësor”*, dhe në nenin 452 të LPK-së i cili përcakton *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyq fituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”*, ngase në shkresat e lëndës vërtetohet se debitori me vendimin e Gjykatës Themelore të Gjilanit P.nr.20/20 CPK.nr.23/20 të datës 17.06.2020, ka fituar kontestin gjyqësor kundër kreditorit. Andaj duke u bazuar në nenin e lartcekur kreditori si palë humbëse në këtë proces gjyqësor ka për detyrë që debitorit t’ia paguaj shpenzimet e shkaktuara gjatë procedurës, e atë për përpilimin e prapësimit në shumë prej 320€. Shuma për pagesë është e bazuar në tarifën e Odës së Avokatëve nr. tarifor 6 me të cilin përcaktohet *“Për përpilimin e parashtrësave me të cilat inicohet zhvillimi i procedurës civile, kontestimore, jo kontestimore, ekonomike, administrative, tatimore, 5 doganore apo cilës do procedurë para gjykatës apo organit tjetër, avokatit i takon shpërblimi: – në çështjet sipas vlerës së çështjes juridike, dhe atë: c) për çështje juridike vlera e të cilave është 10.000 euro e më lartë, shuma me bazë fillestare prej 160,00 euro”* dhe nr. tarifor 9 i cili përcakton *“Për përpilimin e mjeteve juridike, avokatit i takon shpërblimi i dyfishuar nga shpërblimi i paraparë për parashtrësat me të cilat inicohet procedura, në përputhje me numrin tarifor 6. (për padi, kërkesë, prapësim etj.)”*.

Gjykata e shkallës së dytë i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të kreditorit, por të njëjtat nuk ndikuan në një vendim ndryshe.

Kompetenca e Gjykatës së Komeriale, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së (i cili është në fuqi aktualisht, me numër 04 L-139), me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.54/2022, me datë 01.09.2022

Gjyqtari,
Faton Bajrami, d.v.